AKFAL

AGJENCIA KOMBËTARE E FINANCIMIT TË ARSIMIT TË LARTË

# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| Nr. rendor | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfundimit të kërkesë | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 16 | 03.10.2023 | Kërkesë për informacion e studentes përfituese të mbështetjes financiare mbi pajisjen me dokumentacionin i cili verteton shlyerjen e detyrimeve per vitin akademik 2022-2023, | 03.10.2023 | Ju duhet të paraqiteni në sekretarinë e fakultetit për tu pajisur me vërtetimin lidhur me shlyerjen e detyrimeve,<br>Duke ju falenderuar për mirëkuptimin | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 17 | 03.10.2023 | Përshëndetje!<br>Po ju adresohem në lidhje me procedurat që duhen kryer për përfitimin e mbështetjes financiare nga AKFAL për studentët të cilët janë regjistruar në një nga degët prioritare kombëtare.Universiteti i Vlorës na bëri me dije se çdo procedur për përfitimin e mbështetjes financiare varet nga AKFAL dhe sipas ksaj informate, studentët duhen të paraqiten fizikisht në zyrat e AKFAL në Tiranë.Që të përgatitemi paraprakisht, kam disa pyetje.<br>1.Në rast se duhet të paraqitemi fizikisht në çfarë dite të javës jeni hapur deri në çfarë ore?<br>2.Depozitimi i shumës monetare do të hidhet në llogarinë tonë bankare,por konkretisht në cilat banka në Shqipëri operon dhe bashkpunon AKFAL?<br>3.Në rast se nuk është e nevojshme të paraqitemi fizikisht atëher cilat janë hapat që duhet të ndjekim?<br>Shpresoj që pyetjet tona të marrin përgjigje.Falenderojmë AKFAL për punën e tyre të përditshme në ndihmë të gjithë studentëve në vend. | 12.10.2023 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion në lidhje me mbështetjen studentore, ju bëjme me dije se për të aplikuar për Mbështetjen Studentore nevojiten këto dokumenta si më poshte:<br>1.Karteë Identiteti/Pasaportë<br>2.Diploma dhe Certifikata e Maturës Shtetërore<br>3.Vërtetim nga Universiteti që aplikanti është pranuar në programin e studimit të pretenduar,<br>4.Certifikata e fitimit të olipiades për kriterin B<br>Për vitin akademik 2023-2024, aplikimet do të jenë të hapura deri në muajin Janar 2024.<br>Dokumentat duhet të dorëzohen me postë ose dorazi pranë AKFAL, nga dita e hëne deri të premten, brenda orarit zyrtar të punës.<br>Depozitimi i shumës monetare kalohet në llogarinë e çdo studenti nga IAL-ja pranë të cilit studenti ndjek studimet.<br>Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 18 | 03.10.2023 | Kerkesë për informacion mbi vendodhjen e zyrave të AKFAL. | 06.10.2023 | Përshëndetje,<br>Adresa zyrtare e Agjencisë së Financimit të Arsimit të Lartë është Rruga "Naim Frashëri", Nr. 37, Tiranë.<br>Për referencë e gjeni (pranë Garden Building).<br>Faleminderit për mirëkuptimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 19 | 03.10.2023 | Kërkesë për informacion për mbështetjen fiannciare, e një studenti në degën menaxhim agrobiznesi pranë UBT në vitin e 2.Doja të dija më shumë rreth mundësive për financim,dokumentave që duhet të dorzoj dhe ku ndodheni si zyra.<br>Faleminderit! | 06.10.2023 | Përshëndetje,<br><br>Do ju luteshim që për sqarime më të detajuara të paraqiteni fizikisht pranë zyrave tona në adresën: Rruga Naim Frasheri, Numër 37, Tirane. Për lehtësi orientimi mund te kërkoni në Google Map ASCAP (Agjencia Sigurimit të Cilesisë së Arsimit Parauniversitar).<br><br>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 20 | 04.10.2023 | Përshëndetje. Jam një student dhe doja të dija nëse ndryshimet e bera ne ligjin per mbështetjen financiare te degeve prioritare per heqjen e mesatares, reflektohen edhe te ne qe tashme e kemi firmosur kontratën.<br>Faleminderit. | 09.10.2023 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion në lidhje me mbështetjen studentore, ju bëjme me dije se:<br>VKM-ja nr. 386 datë 01.06.2023, e ndryshuar me VKM-në nr. 397/2023 citon shprehimisht se ky vendim i fillon efektet nga viti akademik 2023–2024 e në vijim. Ju jeni përfitues për vitin akademik 2022-2023. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 21 | 04.10.2023 | Pershendetje pas disa here pyetjeje akoma nuk kemi shpjegim ne lidhje me piken 2 te dorezimit te dokumenteve.<br>Pasi kemi pyetur tek administrata nuk e dine se per cfare ka te bej. Ana financiare? se ne skemi pas detyrime financiare vjet. Dhe po na thone se vetem fakulteti po merret me dorezimin e ketyre dokumenteve apo duhet ti dorezojme edhe ne personalisht. Nese po ju lutem duam nje shpjegim per piken 2 apo eshte thjesht nje vertetim studenti. | 06.10.2023 | Përshëndetje,<br><br>Ju bejmë me dije se vërtetimi për shlyerjen e të gjithë detyrimeve për vitin akademik 2022-2023, i referohet faktit që studenti duhet ti ketë marrë të gjitha kreditet . Pra dhënia e të gjithë provimeve dhe kalueshmeria në to.<br><br>Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 22 | 06.10.2023 | Pershendetje!<br>Jam ,studente e Informatikes ne FSHN , perfitoja bursen e ekselences sa paga minimale. Isha para pak minutash ne sekretaria ku me leshuan listen e notave, por per vertetimin qe ju kerkoni si pjese e dokumentacionit me thane qe nuk e leshojme se nuk ka nje te tille. Me thane pjesen qe nqs Jane marre te gjitha kreditet ose jo kjo duket qarte ne lista e notave. Si duhet te veprojme ne kete rast ? | 06.10.2023 | Përshëndetje,<br>Referuar pyetjes suaj do ju luteshim që të kaloni pranë zyrave tona për të dorëzuar dokumentin që dispononi dhe për çdo sqarim të mëtejshëm,<br>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 23 | 20.10.2023 | Pershendetje! Jam nje nxenese e Universitetit Luigj Gurakuqi, Shkoder. Formulari i aplikimit a merret vetem afer agjensise ne Tirane? | 23.10.2023 | Përshëndetje,<br>Në vijim të kërkesës tuaj lidhur me formularin e aplikimit për mbështetjen financiare , ju bëjme me dije se atë mund ta gjeni atë edhe në faqen e instagramit si akfal.gov.al.<br>Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 24 | 23.10.2023 | Pershendetje,<br>Si duhet plotesuar formulari, me shkrim apo si pdf dhe a do e marrin te gjithe studentet e degeve prioritare bursen apo vetem nje pjese e tyre? | 26.10.2023 | Përshëndetje,<br>Referuar kërkesës tuaj, ju bëjmë me dije se formulari i aplikimit duhet të printohet, plotësohet me shkrim dore, firmoset nga ju dhe skanohet. Ai duhet të dergohet në formatin Pdf tek adresa jonë e emailit, sebashku me Id tuaj, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 25 | 25.10.2023 | Pershendetje,<br>Me falni per shqetesimin por jam pak i konfuzuar per kriterin e trete te aplikimit sepse ne Fakultetin "Aleksander Moisiu" ne Durres, spitalle kane dal lajmerimet me nje shembull te aplikimit dhe thote tek kriteri c qe studentet qe kane zgjedhur programe prioritare duhen te kene nje mesatare jo me pak se 8.5 por kete informacion nuk e kam hasur kurre ne kohen para se te dilte ky informacion dhe ne aplikimin qe kane postuar online thote vetem qe te jem ne program prioritare pa kusht mesatareje, kam bere 2 foto te shembullit qe ka nxjerr ekonomistja e shkolles nje te gjithe aplikimit dhe nje fokusuar tek kriteri ne diskutim dhe nje shembull te aplikimit qe eshte postuar online, shpresoje qe te me ndihmoni per kete informacion dhe te me ndimoni me hapat qe duhet te marre per te aplikuar sepse informacionet online nuk jan ne qarta dhe ekonomistja e fakultetit nuk na ndihome | 30.10.2023 | Përshëndetje!<br>Referuar pyetjes tuaj, ju bëjmë me dije se për të aplikuar për mbeshtetjen financiare për vitin akademik 2023-2024 , ju duhet të paraqiteni pranë AKFAL sëbashku me një dokument të vlefshëm identifikimi, me postë, ose të aplikoni onlinë në adresën info.akfal@arsimi.gov.al.<br>Për të aplikuar në programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar për vitin akademik 2023-2024, nuk është kusht mesatarja e studentit.<br>Për me shumë informacion, ju lutem referojuni VMK 386/2022, e ndryshuar, të cilën e gjeni bashkëngjitur dhe shpalljes sonë zyrtare.<br>Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 26 | 27.10.2023 | A jane te ditura cilat jane kushtet pas perfitimit te burses? | 07.11.2023 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të pyetjes tuaj ju informojmë se, procedura dhe kushtet e përfitimit të mbështetjes finaciare për studentët përfitues janë të parashikuara në VKM-në nr.386/2022, e ndryshuar të cilën e gjeni bashkëlidhur.<br>Ju faleminderit | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 27 | 27.10.2023 | Pershendetje! Doja te pyesja ne lidhje me bursen sa rroga minimale per deget prioritare ne njoftimin e dhene thuhet se dokumentet mund te dergohen me ane te gmail, ndersa pak me poshte se formulari i aplikimit vihet ne dispozicion pran AKFAL-it gje qe e ben te detyrueshme paraqitjen pran zyrave.. Per ne qe nuk jetojme ne Tirane dhe do ishte e mira qe ti dergonim dokumentet e nevojshme me ane te gmail si duhet te veprojme duhen skanuar dokumentet dhe derguar apo duhet me detyrim paraqitja pran zyrave te AKFAL-it. Me falni per shqetesimin. Faleminderit. | 31.10.2023 | Përshëndetje!<br>Referuar pyetjes tuaj, ju bëjmë me dije se për të aplikuar për mbeshtetjen financiare për vitin akademik 2023-2024 , ju duhet të paraqiteni pranë AKFAL sëbashku me një dokument të vlefshëm identifikimi, me postë, ose duke aplikuar online.<br>Në rastet kur aplikimi bëhet online.lutemi që formulari i aplikimit të jetë i plotësuar me shkrim dore, i firmosur nga ju dhe i dërguar në formatin Pdf në adresën tonë zyrtare info.akfal@arsimi.gov.al duke bashkëngjitur edhe Id tuaj.<br>Për më shumë informacion ju lutem gjeni bashkëngjitur urdhërin e shpalljes së aplikimit për mbështetjen financiare për vitin akademik 2023-2024. | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 28 | 30.10.2023 | Përshëndetje!<br>Jam një student i cili i përkas njërës prej kategorive të përfitimit të bursës sa vlera e pagës minimale.<br>Ju lutem më vendosni në dispozicion formularin e aplikimit në formatin pdf në mënyrë që ta printoj, ta plotësoj dhe ta dërgoj në rrugët zyrtare të vëna në dispozicion nga AKFAL.<br>Faleminderit paraprakisht! | 31.10.2023 | Përshëndetje!<br>Referuar pyetjes tuaj, ju bëjmë me dije se për të aplikuar për mbeshtetjen financiare për vitin akademik 2023-2024 , ju duhet të paraqiteni pranë AKFAL sëbashku me një dokument të vlefshëm identifikimi, me postë, ose duke aplikuar online.<br>Në rastet kur aplikimi bëhet online.lutemi që formulari i aplikimit të jetë i plotësuar me shkrim dore, i firmosur nga ju dhe i dërguar në formatin Pdf në adresën tonë zyrtare info.akfal@arsimi.gov.al duke bashkëngjitur edhe Id tuaj.<br>Për më shumë informacion ju lutem gjeni bashkëngjitur urdhërin e shpalljes së aplikimit për mbështetjen financiare për vitin akademik 2023-2024. | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 29 | 31.10.2023 | Presja e vendosur tek mënyrat e dorëzimit nënkupton vetëm njërën mënyrë, pra nëse bëj aplikimin me anë të emailit duke skanuar formularin dhe kartën e identitetit, nuk ka nevojë që ti nis me postë ose ti dorëzoj dorazi tek AKFAL këto dokumenta? | 07.11.2023 | Përshëndetje,<br><br>Referuar pyetjes suaj, ju bëjmë me dije se ju mud të aplikoni në rrugë zyrtare, rrugë elektronike në adresën tonë të emailit, ose dorazi pranë ambienteve të AKFAL. Bashkëngjitur keni edhe shpalljen lidhur me aplikimet për mbështetjen financiare viti akademik 2023-2024. | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 30 | 31.10.2023 | Pershendetje!<br>Jam studente ne vitin e pare per mesuesi fillore ne Fakultetin e Shkencave Humane Vlore. Mund te na jepni ndonje informacion si duhet te veprojm dhe ku mund t'a gjejm formularin?<br>Jam ne pritje te pergjigjes tuaj<br>Faleminderit | 31.10.2023 | Përshëndetje!<br>Referuar pyetjes tuaj, ju bëjmë me dije se për të aplikuar për mbeshtetjen financiare për vitin akademik 2023-2024 , ju duhet të paraqiteni pranë AKFAL sëbashku me një dokument të vlefshëm identifikimi, me postë, ose duke aplikuar online.<br>Në rastet kur aplikimi bëhet online.lutemi që formulari i aplikimit të jetë i plotësuar me shkrim dore, i firmosur nga ju dhe i dërguar në formatin Pdf në adresën tonë zyrtare info.akfal@arsimi.gov.al duke bashkëngjitur edhe Id tuaj.<br>Për më shumë informacion ju lutem gjeni bashkëngjitur urdhërin e shpalljes së aplikimit për mbështetjen financiare për vitin akademik 2023-2024. | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 31 | 31.10.2023 | Mjeti i identifikimit duhet te jet ne pdf gjithashtu? Dhe a eshte e nevojshme dergimi i vertetimit qe jam pjes e nje univeriteti dhe diploma e noterizuar dhe certefikata e notave? | 07.11.2023 | Përshëndetje!<br>Referuar pyetjes tuaj, ju bëjmë me dije se për të aplikuar për mbeshtetjen financiare për vitin akademik 2023-2024, ju nevojitet të plotësoni vetem formularin e aplikimit.<br>Për më shumë informacion ju lutem gjeni bashkëngjitur shpallejn për aplikim lidhur me mbështetjen financiare për vitin akademik 2023-2024.<br>Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 32 | 02.11.2023 | Përshëndetje si jeni? Të më falni për shqetesimin desha të dij çfar dokumentash duhen për të mar bursë ?<br>Unë plotësoj kushtin e një prej degëve prioritet kombëtar.<br>Faleminderit! | 03.11.2023 | Përshëndetje!<br>Referuar pyetjes tuaj, ju bëjmë me dije se për të aplikuar për mbeshtetjen financiare për vitin akademik 2023-2024 , ju duhet të paraqiteni pranë AKFAL sëbashku me një dokument të vlefshëm identifikimi, me postë, ose duke aplikuar online.<br>Në rastet kur aplikimi bëhet online.lutemi që formulari i aplikimit të jetë i plotësuar me shkrim dore, i firmosur nga ju dhe i dërguar në formatin Pdf në adresën tonë zyrtare info.akfal@arsimi.gov.al<br>Për më shumë informacion ju lutem gjeni bashkëngjitur urdhërin e shpalljes së aplikimit për mbështetjen financiare për vitin akademik 2023-2024.<br>Duke ju falënderuar për mirekuptimin | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 33 | 06.11.2023 | Pershendetje doja tju pyesja deri ne cilin orar qendra juaj eshte e hapur | 07.11.2023 | Përshëndetje,<br><br>Referuar pyetjes suaj, ju bëjme me dije se orari zyrtar kur ju mund të paraqiteni është nga e hëna në të enjte në orarin 08:00-16:30, të premte ora 08:00-14:00. | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 34 | 04.11.2023 | Pershendetje, jami nxenese e vitit te pare te ciklit bachelor ne degen e arsimit parashkollor. Jam e interesuar per bursen sa paga minimale por nuk jam e informuar per dokumentet qe duhen dorezuar. A mund te mi dergoni cilat duhen dorezuar? | 07.11.2023 | Përshëndetje,<br>Referuar pyetjes tuaj, ju bëjme me dije se për të aplikuar për mbështetjen financiare viti akademik 2023-2024, ju duhet të plotësoni vetëm formularin e aplikimit i cili gjendet bashkëngjitur,<br>Duke ju falënderuar për mirekuptimin | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 35 | 10.11.2023 | Pershendetje nje pytje kisha po IBANIN a duhet ta dergojm bashk me formularin e aplikimit? | 09.11.2023 | Përshëndetje,<br>Referuar pyetjes suaj, ju bëjmë me dije se ju mud të aplikoni  për mbështetjen financiare viti akademik 2023-2024, në rrugë zyrtare, rrugë elektronike në adresën tonë të emailit, ose dorazi pranë ambienteve të AKFAL. Për të bërë aplikimin, ju mjafton vetëm plotësimi i formularit të aplikimit.<br>Ju faleminderit! | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 36 | 10.11.2023 | Pershendetje. Si jeni?<br>Cilat jane dokumentat qe duhet te paraqis per te perfituar bursen per deget prioritare?<br>Faleminderit | 13.11.2023 | Përshëndetje,<br>Referuar kerkeses tuaj, ju bëjmë me dije se ju mud të aplikoni në rrugë zyrtare, rrugë elektronike në adresën tonë të emailit, ose dorazi pranë ambienteve të AKFAL. Për të aplikuar, ju nevojitet vetëm formulari i aplikimit, të cilin duhet ta plotësoni me shkrim dore dhe ta firmosni. Formularin mund ta gjeni bashkëngjitur sëbashku me shpalljen e aplikimit për mbështetjen financiare viti akademik 2023-2024. | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 37 | 13.11.2023 | E nderuar AKFAL, Une jam ______<br>Nje studente nga Tirana e cila studion me Universitetin "Aleksander Moisiu" ne Durres. Po shkruaj për të shprehur interesin tim të fortë për t'u pranuar per perfitimin e ligjit te ri në programin e deges prioritare te Arsimit Parashkollor.<br>Gjatë gjithë rrugëtimit tim arsimor, unë kam qenë thellësisht e apasionuar për lendën e arsimit parashkollor dhe kam dashur prej kohe<br>Jam i emocionuar për mundësinë për të studiuar per arsimin parashkollor në Universitetin "Aleksander Moisiu" dhe per marrjen e pageses sipas ligjit te ri per lenden prioritare.<br>Kërkoj që komisioni i pranimeve të marrë në konsideratë aplikimin tim për programin e Arsimit Parashkollor. E kuptoj natyrën konkurruese të procesit të pranimit, por jam i vendosur të sjell përkushtimin dhe entuziazmin tim në Universitetin Aleksander Moisiu.<br>Faleminderit që gjetët kohë për të shqyrtuar aplikimin tim.<br>Ju lutem mos ngurroni të më kontaktoni nëse ka ndonjë material ose informacion shtesë të nevojshëm për të mbështetur aplikimin tim. Faleminderit për kohën dhe konsideratën tuaj. | 13.11.2023 | Përshëndetje,<br>Referuar kerkeses tuaj, ju bëjmë me dije se ju mud të aplikoni në rrugë zyrtare, rrugë elektronike në adresën tonë të emailit, ose dorazi pranë ambienteve të AKFAL. Për të aplikuar, ju nevojitet vetëm formulari i aplikimit, të cilin duhet ta plotësoni me shkrim dore dhe ta firmosni. Formularin mund ta gjeni bashkëngjitur sëbashku me shpalljen e aplikimit për mbështetjen financiare viti akademik 2023-2024. | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 38 | 14.11.2023 | Pershendetje. Per buresen me program studimi prioritar dergova email me letren e plotesuar me shkrim dore. Si funksionon tani kur dalin pergjigjet dhe si do informohemi?<br>Faleminderit paraprakisht | 20.11.2023 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të kërkesës për informacion, në lidhje me aplikimin tuaj për përfitimin e mbështetjes financiare ju bëjmë me dije se:<br>Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë është duke kryer verifikimet paraprake në lidhje me plotësimin e kritereve dhe kushteve për aplikim sipas VKM nr.386/2022, i ndryshuar.<br>Ju do të infromoheni në lidhje me konkluzionet e arritur mbi aplikimin tuaj në përfundim të procesit,<br>Ju falëminderit, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 39 | 15.11.2023 | Pershendetje !<br>Une jam Semina Koçiaj , studente ne Universitetin “Ismail Qemali” Vlore , ne degen Biologji , viti i dyte Bachelor . Ju kontaktoj ne lidhje me njoftimet qe kam marre koheve te fundit , per kriteret e perfitimit te mbeshtetjes financiare studentore ne baze te mesatares se studentit .<br>Kerkoj nga ju nje informacion ne lidhje me keto kritere , duke qene se kete vit kriteri i mesatares se perfitimit te kesaj burse nuk ekziston me , dhe ne qofte se ky kriter mbeshtetet ne baze te nje ligji , me konfuzon fakti qe eshte i vlefshem vetem  per studentet qe aplikojne kete vit dhe jo per studentet qe tashme e kane bere kete marreveshje , pra per studentet e vitit te dyte .<br>Gjithashtu , do ta vleresoja nje informacion nese kjo marreveshje mund te rinovohet ose jo ne baze te ketij ligji te ri.<br>Ne pritje te nje pergjigjeje nga ju ,<br>Faleminderit ! | 20.11.2023 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë se:<br>Në pikën 2 të VKM-së nr. 397/2023, nëpërmjet së cilit ndryshoi VKM nr.386/2022 (mbi bazën e së cilit ju keni nënshkruar marrëveshjen trepalëshe për vitin akademik 2022-2023), parashikohet se ndryshimet dhe ky vendim do të shtrijnë efektet e tij nga viti akademik 2023–2024 e në vijim.<br>Sa më sipër, ju informojmë se marrëveshja e nënshkruar nga ana juaj mbetet e pa ndryshuar.<br>Duke ju falënderuar për mirëkuptimin | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 40 | 17.11.2023 | Pershendetje,jam studenti Rigers Bejko i deges Menaxhim ne Turizem dhe Mikpritje,kisha bere nje aplikim per mbeshtetjen financiare dhe sapo me erdhi nje pergjigje qe nuk e perfitoj pasi e kam program te dyte studimi ose jam duke ndjekur nje program tje... | 20.11.2023 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të emailit tuaj, ju informojmë se sipas verifikimeve të bëra paraprakisht nga ana jonë pranë QSHA, rezulton se ju jeni i regjistruar ose keni përfunduar studimet në Shkenca Ushtarake, Akademia e Forcave të Armatosura. Ndërkohë keni aplikuar për të përfituar mbështetje financiare për programin e studimit "Menaxhim në Turizëm dhe Mikëpritje" Universiteti Fan S. Noli i Korcës.<br>AKFAL me qëllim shqyrtmin e ankesës së administruar do të ri-verifikojë rastin tuaj pranë QSHA dhe në vijim ju do të njoftoheni në lidhje me përfundimet e arritura.<br>Ju falëminderit për mirëkuptimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 41 | 17.11.2023 | Pershendetje!<br>Per sa i perket me siper, emailit te derguar nga ana juaj, dega ime e studimit nuk eshte "informatika" sic eshte cilesuar ne email, por eshte "Inxhinjeria Agronomike" dhe eshte nje nga deget prioritare te vendosura nga ministria. Dua te rishikohet dhe nje here kerkesa dhe te behen korigjimet e duhura nga ana juaj. Po ju nis dhe nje here formularin e plotesuar nga ana ime persa i perket deges ku une studjoj. Ne formular cilesohet dega "inxhinjeri Agronomike", e cila eshte dege prioritare<br>Duke ju falenderuar. | 20.11.2023 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të emailit tuaj, fillimisht ju kërkojmë ndjesë për cilësimin gabim të programit të studimit për të cilin ju keni aplikuar, për të përfituar mbështetje financiare, ndërsa ju informojmë si më poshtë:<br>Në zbatim të dispozitave të VKM Nr.386/2022, të ndryshuar, studenti i cili përfiton mbështetje financiare ka detyrimin të punësohet për 3 vjet, brenda 6 viteve, në sektorin shtetëror. AKFAL përgjatë procesit të verifikimit të aplikimeve, bazuar në datëlindjen Tuaj, ka konstatuar faktin se ju jeni në moshë e cila nuk garanton zbatimin e detyrimit të punësimit, sipas kushteve të VKM-së nr.386/2022, të ndryshuar. Në përfundim të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve (4-5 vite minimalisht), për shkak të moshës, Ju do të keni mundësi të përfitoni nga dispozitat ligjore që rregullojnë pensionin e pleqërisë. Për rrjedhoje, Ju nuk do të mund të zbatoni detyrimet e marrëveshjes (tre-palëshe) për punësimin e studentit përfituesi.<br>Sa më sipër, rezulton se ju nuk plotësoni një nga kushtet e nevojshme për të përfituar mbështetje fiannciare sipas vendimit të sipërcituar.<br>Duke ju falënderuar për mirëkuptimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 42 | 17.11.2023 | Pershendetje. Me erdhi nje email pak me perpara qe thote se nuk mund te perfitoj ndihmen financiare sepse po ndjek nje program tjeter studimi.<br>Mund te me thoni se cilin program tjeter qenkam duke ndjekur, sepse une ne djenine time vetem Inxhinjeri agronomike po ndjek.<br>Duhet te jete bere ndonje gabim prandaj ju lutem rishikojeni dhe njehere. | 20.11.2023 | Përshëndetje,<br>Ju bëjmë me dije se e morëm ankesën tuaj. Ju pretendoni se programi i studimit për të cilin ju keni aplikuar është programi juaj i parë i studimit, pasi ju jeni çregjistruar dhe nuk keni përfunduar studimet në programin "Administrim Biznesi në Turizëm", Universiteti Fan S. Noli i Korcës.<br>Lutemi nga ana juaj të na dërgohet dokumentacioni provues i këtij çregjistrimi.<br>Gjithashtu, ju infomojmë se AKFAL me qëllim shqyrtmin e ankesës së administruar do të ri-verifikojë rastin tuaj pranë QSHA dhe në vijim ju do të njoftoheni në lidhje me përfundimet e arritura.<br>Ju falëminderit për mirëkuptimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 43 | 17.11.2023 | Përshëndetje!<br>Kam marrë njoftim për mosplotësim kriteresh për mbështetjen financiare.<br>Mund të më informoni cilin program tjetër studimi po ndjek, sepse unë në djenin time po ndjek vetëm Arsim Fillor. Besoj se duhet te jete bërë një ngatresë.Pres pergjigje.<br>Faleminderit!! | 20.11.2023 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të emailit tuaj, ju informojmë se AKFAL me qëllim shqyrtimin e ankesës tuaj do të ri-verifikojë rastin pranë QSHA dhe në vijim ju do të njoftoheni në lidhje me përfundimet e arritura.<br>Ju falëminderit për mirëkuptimin | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 44 | 18.11.2023 | Pse na kan rrejte se neva na ka than se esht deg proitare Teknologjia agroushqimore edhe ju aty na that se esht deg proitare nese neve nuk na qesin bursen ne do qohem te Hane gjith universiteti i bujqsorit Proteste ! | 20.11.2023 | Përshëndetje,<br>Ju informojmë se e morëm ankesën tuaj. Ju parashtroni shqetësimin në lidhje me moscilësimin si prioritet kombetar të programit të studimit "Inxhinieri Agroushqimore, Profili: Teknologji Ushqimore", në Unievrsitetin Bujqësor të Tiranës.<br>Ju sqarojmë si më poshtë:<br>Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë ushtron veprimtarinë e saj në përputhje dhe zbatim të gjithë akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ju keni aplikuar për të përfituar mbështetje financiare si student që ndiqni një program prioritar studimi, ndërkohë që programi i deklaruar nga ana juaj në formularin e aplikimit, nuk përbën prioritet kombëtar.<br>Sa më sipër, bashkëlidhur ju përcjellim shtojcën Nr.1, të VKM Nr. 386, datë 01.06.2022, të ndryshuar, ku përcaktohen emërtimet e programeve që përbëjnë prioritet kombëtar dhe ku nuk përfshihet programi "Inxhinieri Agroushqimore, Profili: Teknologji Ushqimore".<br>Faleminderit, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 45 | 20.11.2023 | I/e nderuar,<br>Jam Meruan Bode, student ne programin Mjekesi e Pergjithshme, viti i pare. Si nje nxenes qe permbush kriteret, dje kam bere dergesen e dokumenteve te kerkuara per bursen e cila eshte sa rroga minimale me Posten Shqiptare. UNE JAM STUDENT I REGJISTRUAR NE VITIN 2023-2024, POR GABIMISHT KAM DERGUAR NJE FORMULAR TE GABUAR TE VITIT 2022-2023. Mund te me sugjeroni nje zgjidhje ju lutem ? Faleminderit.<br>Me respekt | 20.11.2023 | Përshendetje,<br>Në përgjigje të emailit tuaj, ju informojmë se formati i formularit të aplikimit i vitit akademik 2022-2023, i cili është dërguar nga ana juaj pranë nesh, nuk përbën shkak për mos pranimin e aplikimit nga AKFAL.<br>Bashkëlidhur do të gjeni formularin e aplikimit për mbështetje financiare, për vitin akademik 2023-2024, të cilin mund ta dërgoni të skanuar në këtë adresë email, së bashku me një mjet identifikimi.<br>Ju falemiderit, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 46 | 20.11.2023 | Pershendetje !<br>Kam mare nje email ku shkruhej se isha ne ndjekje te nje programi te dyte studimi ose kam mbaruar nje fakultet tjeter dhe per rrjedhoje nuk perfitoj mbeshtetje financiare per deget prioritare nderkohe qe une jam çrregjistruar qe nga ai program qe ne qershor te ktij viti dhe nuk kam mare asnje lloj diplome dhe nuk jam ne ndjekje te nje fakulteti te dyte po ju coj me foto dhe vertetimin e çrregjistrimit mga sekretaria korce ju lutem nqs keni mundesi me ktheni pergjigje<br>Faleminderit ! Redion Hajrani eshte ky?/ | 20.11.2023 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të emaili tuaj, ju informojmë se sipas verifikimeve të bëra paraprakisht nga ana jonë pranë QSHA, rezulton se ju jeni i regjistruar ose keni përfunduar studimet në programin e studimit "Histori – Gjeografi", Universiteti Fan S. Noli i Korcës.<br>AKFAL me qëllim shqyrtmin e ankesës së administruar, do të ri-verifikojë rastin tuaj pranë QSHA dhe në vijim ju do të njoftoheni në lidhje me përfundimet e arritura.<br>Ju falëminderit për mirëkuptimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 47 | 20.11.2023 | Pershendetje,<br>Ne vijim te takimit ne zyrat tuaja po ju dergoj dokumentacionin e kerkuar per rishikim te kualifikimit per mbeshtetje financiare, per shkak te specifikave te rastit tim.<br>Bashkangjitur gjeni vertetimin e çregjistrimit nga fakulteti i meparshem, i bere vullnetarisht, ne perputhje me rregulloren e UT, dhe i noterizuar prane noteres, si kerkese e UT per te zyrtarizuar çregjistrimin. Kjo e ben Historine, si dege prioritare qe une ndjek kete vit, teknikisht programin tim te pare te studimit, ku une pres te diplomohem. Theksoj qe nuk e kam perfunduar shkollen tjeter, nuk jam diplomuar, e kam nderprere pas vitit te dyte, dhe as jam pjese aktive ose pasive e ndonje universiteti aktualisht, pervec FHF, ku jam pranuar ne degen Histori. Arsyeja e nderprerjes, nder te tjera, ka qene edhe deshira per te studiuar Histori, dhe shpresoj shume qe tani qe mu dha mundesia, mos te penalizohem nga fakti qe kam ndjekur per disa kohe nje fakultet tjeter, nga i cili jam shkeputur plotesisht, pa e mbyllur ciklin bachelor.<br>E kam pritur me shume entuziazem faktin qe qeveria do te na mbeshtese financiarisht, dhe jam bere pjese e fakultetit me mesatare gjimnazi 8.9, qe me jep mundesi te zgjidhja shume dege te tjera studimi.<br>Shpresoj shume ta merrni ne konsiderate sakrificen qe po bej, dhe ta rikonsideroni dhe nje here vendimin per te me skualifikuar paraprakisht. Sic e theksova dhe ne takim, teknikisht i plotesoj kushtet per ta konsideruar progamin ku studioj aktualisht si program te pare studimi, perderisa jam i padiplomuar, dhe ju kujtoj qe kualifikimi per ne raundin tjeter nuk do ti kushtoje buxhetit te shtetit asgje ekstra, pasi seleksionimi final do te behet nga fakulteti sipas kuotave perkatese.<br>Pres pergjigje nga ju se shpejti.<br>Ju uroj pune te mbare. | 01.12.2023 | Përshëndetje,<br>Ju bëjmë me dije se e morëm ankesën tuaj, AKFAL me qëllim shqyrtmin e ankesës së administruar, do të ri-verifikojë rastin tuaj pranë QSHA dhe në vijim ju do të njoftoheni në lidhje me përfundimet e arritura.<br><br>Ju falëminderit për mirëkuptimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 48 | 21.11.2023 | Pershendetje. Jam nje student i matematike fizike tek universiteti :"Ismail Qemali" Vlore dhe isha i interesuar se cfare dokumentash duhen dorezuar per bursen qe jepet dhe ku duhet ti dorezoj ne Tirane? | 01.12.2023 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të kerkeses tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se ju mud të aplikoni në rrugë postare ose dorazi pranë ambienteve të AKFAL në adresën Rruga "Naim Frashëri", nr.37, Tiranë, si dhe në rrugë elektronike në adresën tonë të emailit "info.akfal@arsimi.gov.al". Për të aplikuar, ju nevojitet vetëm formulari i aplikimit, të cilin duhet ta plotësoni me shkrim dore dhe ta firmosni. Formularin mund ta gjeni bashkëngjitur së bashku me shpalljen e aplikimit për mbështetjen financiare viti akademik 2023-2024.<br>Duke ju falënderuar për mirëkuptimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 49 | 21.11.2023 | Pershendetje si jenj ?<br>Jam Eldorado Kallfa edhe studioj per degen prioritare " Navigacion" ne Universitetin e Vlores " Ismail Qemali" dhe doja tju pyesja per disa gjera me posht . Per aplikimin e formularit duheshin :<br>- kerkesa e aplikimit pra fleten qe kemi marr<br>- dokument i identifikimit<br>-diploma e matures shteterore<br>-vertetim nga institucioni publik i arsimit te larte, qe aplikanti eshte pranuar ne nje program studimi .<br>Keto kerkesa qe parashtrova me lart duhet ti nisim online ketu ne email apo ne gmail apo do duhet te bejm nje dosje edhe ti nisim me poste?<br>Jam ne pritje te nje pergjigje prej jush<br>Me respekt | 01.12.2023 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të kerkeses tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se ju mud të aplikoni në rrugë postare ose dorazi pranë ambienteve të AKFAL në adresën Rruga "Naim Frashëri", nr.37, Tiranë, si dhe në rrugë elektronike në adresën tonë të emailit "info.akfal@arsimi.gov.al". Për të aplikuar, ju nevojitet vetëm formulari i aplikimit, të cilin duhet ta plotësoni me shkrim dore dhe ta firmosni. Formularin mund ta gjeni bashkëngjitur së bashku me shpalljen e aplikimit për mbështetjen financiare viti akademik 2023-2024.<br>Duke ju falënderuar për mirëkuptimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 50 | 21.11.2023 | Pershendetje te nderuar,<br>.une ne vitin akadimik 2022jam regjistruar ne universitetin e Shkencave te Rehabilitimit dhe jam paraqitur vetem nje muaj dhe e kam nderprere.Kete vit te ri studimi u regjistova dhe vazhdoj Universitetin prane UBT per Teknologji Agroushqimore , ku kam derguarvprane sekretarise , dokumentin e cregjistrimit nga Universiteti i Shkencave te rehabilitimit ku mund ta vertetoni.<br>Ju lutem rishikoni edhe njeher me detaj kete gje .<br>Faleminderit ne pritje te pergjigjes tuaj | 01.12.2023 | Përshëndetje,<br>Ju bëjmë me dije se e morëm ankesën tuaj, AKFAL me qëllim shqyrtmin e ankesës së administruar, do të ri-verifikojë rastin tuaj pranë QSHA dhe në vijim ju do të njoftoheni në lidhje me përfundimet e arritura.<br>Ju falëminderit për mirëkuptimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 51 | 21.11.2023 | u lutem a mund te me ktheni pergjigje perse nuk mund te mar mbeshtetje per studimet ?<br>Me keni shkrojtur se nuk i plotsoj kushtet,se po vazhdoj fakultet dhe ose kam mbaruar.<br>Do t'ju lutesha qe te kontrolloni mire dojkumentet se un nuk vazhdoj shkolle dhe as nuk kam mbaruar fakultet.<br>Un kam mbaruar vetem gjimnaz para kater vite, pastaj u regjistrova ne fakultet pornuk vazhdova u ç'regjistrova sepse nuk kisha mundesi te paguaja fakultetin per arsye ekonomike dhe tani aplikova prap duke menduar se do merja mbeshtetje dhe do kisha mundesi ta vazhdoja fakultetin. Keshtu mbetem prap pa mundesi per te vazhduar fakultetin sepse nuk kam mundesi financiare qe ta paguaj.<br><br>Faleminderit per mirkuptimin! | 01.12.2023 | Përshëndetje,<br>Ju bëjmë me dije se e morëm ankesën tuaj. Ju pretendoni se programi i studimit, për të cilin ju keni aplikuar për të përfituar mbështetje financiare, është programi juaj i parë i studimit, pasi ju jeni çregjistruar dhe nuk keni përfunduar studimet në programin "Shërbim Social", në Universiteti Fan S. Noli, Korcë.<br>Lutemi nga ana juaj të na dërgohet në email dokumentacioni provues i këtij çregjistrimi.<br>Gjithashtu, ju infomojmë se AKFAL me qëllim shqyrtimin e ankesës së administruar do të ri-verifikojë rastin tuaj pranë QSHA dhe në vijim ju do të njoftoheni në lidhje me përfundimet e arritura.<br>Ju falëminderit për mirëkuptimin | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 52 | 21.11.2023 | Pershendetje,po ju njoftoj ne lidhje me emailin qe morra,po kam qene i rregjistruar vitin e kaluar ne "Akademine e Forcave te Armatosura" por brenda javes kam dhene doreheqjen dhe jam crregjistruar.Ju lutem rishikojeni. | 01.12.2023 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të emaili tuaj, ju informojmë se sipas verifikimeve të bëra paraprakisht nga ana jonë pranë QSHA, rezulton se ju jeni i regjistruar ose keni përfunduar studimet në Shkenca Ushtarake, Akademia e Forcave të Armatosura. Ndërkohë keni aplikuar për të përfituar mbështetje financiare për programin e studimit "Menaxhim në Turizëm dhe Mikëpritje" Universiteti Fan S. Noli i Korcës.<br>Lutemi nga ana juaj të na dërgohet në email dokumentacioni provues i këtij çregjistrimi.<br>AKFAL me qëllim shqyrtmin e ankesës së administruar do të ri-verifikojë rastin tuaj pranë QSHA dhe në vijim ju do të njoftoheni në lidhje me përfundimet e arritura.<br>Ju falëminderit për mirëkuptimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 53 | 23.11.2023 | Pershendetje.un nuk kam perdunduar as nuk jam ne nje shkoll tjeter | 01.12.2023 | Përshëndetje,<br>Ju bëjmë me dije se e morëm ankesën tuaj. Ju pretendoni se programi i studimit, për të cilin ju keni aplikuar për të përfituar mbështetje fiannciare, është programi juaj i parë i studimit, pasi ju jeni çregjistruar dhe nuk keni përfunduar studimet në programin "Shkenca Juridike ne sektorin Publik" Universiteti Aleksandër Xhuvani Elbasan.<br>Lutemi nga ana juaj të na dërgohet në email dokumentacioni provues i këtij çregjistrimi.<br>Gjithashtu, ju infomojmë se AKFAL me qëllim shqyrtimin e ankesës së administruar do të ri-verifikojë rastin tuaj pranë QSHA dhe në vijim ju do të njoftoheni në lidhje me përfundimet e arritura.<br>Ju falëminderit për mirëkuptimin | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 23.11.2023 | Pershendetje ! Po dergoj formularin e aplikimit per perfitim te mbeshtetjes financiare me gmail. A kam nevoje tu a dergoj edhe me poste ? Faleminderit per mirkuptimin. Respekte! | 24.11.2023 | Përshëndetje,<br>Ju falenderojmë për emailin e dërguar, por kujdesuni që të bashkangjisni formularin e aplikimit në email.<br>Gjithashtu, gjeni bashkangjitur thirrjen e hapjes së aplikimeve për mëeshtetjen financiare 2023-2024. Sikurse vihet re, ju mund te aplikoni fizikisht pranë zyrave të AKFAL, në rrugë postare ose në adresën tonë zyrtare të emailit info.akfal@arsimi.gov.al.<br>Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, | | |
| 54 | 23.11.2023 | Pershendetje si mund ta dalloj qe do e marr bursen e deges prioritare pra si do e kuptoj une qe e kam perfituar. | 01.12.2023 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të kerkeses tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se ju do të informoheni në lidhje me përfundimet e arritura mbi aplikimin tuaj për të përfituar mbështetje financiare në përfundim të procesit.<br>Ju faleminderit, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| | 24.11.2023 | Pershendetje un kam qenë i regjistruar vjet ne 1 program studimi nga ku jam çrregjistruar dhe kte vit aplikova perseri ne kte program studimi Inxhinieri Agrare profili "Mbrojtje Bimesh".Un as nuk kam perfunduar dhe as nuk jam duke ndjekur ndonj program… | 01.12.2023 | Përshëndetje,<br>Ju bëjmë me dije se e morëm ankesën tuaj, AKFAL me qëllim shqyrtmin e ankesës së administruar, do të ri-verifikojë rastin tuaj pranë QSHA dhe në vijim ju do të njoftoheni në lidhje me përfundimet e arritura.<br>Ju falëminderit për mirëkuptimin, | | |
| 55 | 24.11.2023 | Pershendetje !<br>Ju kam shkruar per rastin tim qe nuk jam ne ndjekje te nje fakulteti te dyte dhe nuk kam mare asnje diplome . Nqs keni mundesi me informoni e verifikuat prane Q.Sh.A rastin tim dhe a nevoitet ndonje dokumentacion nga ana ime per ta vertetuar kte gje me njoftoni ju lutem .<br>Faleninderit ! | 30.11.2023 | Përshëndetje,<br>Ju bëjmë me dije se ju do të njoftoheni në lidhje me përfundimet e arritura pas procesit të verifikimit dhe shqyrtimit të rastit tuaj nga ana jonë, brenda afateve të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.<br>Ju falëminderit për mirëkuptimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 56 | 27.11.2023 | Pershendetje!<br>Unë që po ju shkruaj jam Edja Feçanji, studente në Bachelor për “Gjuhë shqipe dhe Letërsi”. Ju shkruaj nëse mund të më ndihmoni duke më informuar në lidhje me dokumentacionin e nevojshëm për aplikimin për bursën e degëve prioritare. | 30.11.2023 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të kerkeses tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se ju mud të aplikoni në rrugë postare ose dorazi pranë ambienteve të AKFAL në adresën Rruga "Naim Frashëri", nr.37, Tiranë, si dhe në rrugë elektronike në adresën tonë të emailit "info.akfal@arsimi.gov.al". Për të aplikuar, ju nevojitet vetëm formulari i aplikimit, të cilin duhet ta plotësoni me shkrim dore dhe ta firmosni. Formularin mund ta gjeni bashkëngjitur sëbashku me shpalljen e aplikimit për mbështetjen financiare viti akademik 2023-2024.<br>Duke ju falënderuar për mirëkuptimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 57 | 27.11.2023 | I nderuar zoti Spahiu,<br>Jam nje studente qe i plotesoj kriteret per aplikim per mbeshtetje financiare per studentet ekselente.<br>Kerkoj sqarime per ceshtjet e meposhtme per aplikimin;<br>1. duhet dorezuar vetem formulari apo edhe dokumentet mbeshtetes?<br>2. Duhen noterizuar diploma dhe certifikata e notave?<br>3. Ne rastin kur dergohen me email, a pranohen te skanuara?<br>Faleminderit per kohen tuaj! | 06.12.2023 | Referuar kerkeses tuaj, ju bëjmë me dije se ju mud të aplikoni në rrugë zyrtare, rrugë elektronike në adresën tonë të emailit, ose dorazi pranë ambienteve të AKFAL. Për të aplikuar, ju nevojitet vetëm formulari i aplikimit, të cilin duhet ta plotësoni me shkrim dore dhe ta firmosni. Formularin mund ta gjeni bashkëngjitur sëbashku me shpalljen e aplikimit për mbështetjen financiare viti akademik 2023-2024. | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 58 | 28.11.2023 | Pershendetje!<br>Ka ndonje te re ne lidhje me ceshtjen time?<br>Vertetimin e cregjistrimit e dergova, ne qofte se e keni vene re.<br>Do ishte mire te me jepnit ndonje informacion...<br>Faleminderit! | 06.12.2023 | Përshëndetje,<br>Ju bëjme me dije se ju do të njoftoheni në lidhje me përfundimet e arritura pas procesit të verifikimit dhe shqyrtimit të rastit tuaj nga ana jonë, brenda afateve të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.<br><br>Ju falëminderit për mirëkuptimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 59 | 30.11.2023 | Pershendetje,pasi kam hasur nje problem me perfitimin e burses prioritare,jam I interesuar te di nese ka nje zyre per tu paraqitur per te biseduar nga afer? | 30.11.2023 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të kerkeses tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju mund të paraqisni çdo pyetje, kerkese apo paqartesi në adresën tonë të emailit "info.akfal@arsimi.gov.al". Gjithashtu ju bejme me dije se, AKFAL ushtron veprimtarinë e tij në adresën: Rruga "Naim Frashëri", nr. 37, Tiranë; Orari: E hënë- E enjte: 8:00-16:30 dhe e premte - 8:00-14:00.<br>Ju faleminderit | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 60 | 04.12.2023 | Përshëndetje,<br>Në adresën e koordinatorit për të drejtën e informimit në MAS është përcjellë kërkesa si më poshtë.<br>Lutem trajtimin e pyetjeve për të cilat keni informacion, brenda afatit ligjor të parashikuar në ligjin nr.119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar.<br>Faleminderit, | 05.12.2023 | Përshëndetje,<br>Për sa parashtrohet në kërkesën për informim te znj. ____, AKFAL disponon të dhënat për pikat 1,2 dhe 3, të cilat i gjeni në materialin bashkëlidhur.<br>Ju Faleminderit, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 61 | 04.12.2023 | Pershendetje Po un Jam Qrregjistruar Nga ajo Deg A ka naj Problem Kjo gje | 06.12.2023 | Përshëndetje,<br>Ju informojmë se e morëm ankesën tuaj. Ju pretendoni se programi i studimit për të cilin ju keni aplikuar është programi juaj i parë i studimit, pasi ju jeni çregjistruar dhe nuk keni përfunduar studimet në programin "Inxhinieri Mjedisi", Universiteti Politeknik i Tiranës.<br>Lutemi nga ana juaj të na dërgohet dokumentacioni provues i këtij çregjistrimi.<br>Gjithashtu, ju infomojmë se AKFAL me qëllim shqyrtmin e ankesës së administruar do të ri-verifikojë rastin tuaj pranë QSHA dhe në vijim ju do të njoftoheni në lidhje me përfundimet e arritura.<br>Ju falëminderit për mirëkuptimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 62 | 04.12.2023 | Pershendetje,<br>Shpresoj qe ky email t'ju gjeje mire dhe me shendet te plote ju dhe stafin tuaj.<br>Quhem __ jam 24 vjece, vij nga Shkodra, dhe jam studente per te Drejten Penale, nivel Masteri Shkencor ne Universitetin e Leiden. Ne shtator u perzgjodha per nje vend praktike prane Gjykates Penale Nderkombetare ne Hage, Hollande nga rreth 500 aplikante. Ne anglisht njihet si International Criminal Court dhe eshte gjykata me e rendesishme ne bote per perndjekjen e krimeve nderkombetare.<br>Une po ju shkruaj pasi bursa qe kisha nga universiteti i Leiden mbaron ne fund te dhjetorit. Mirepo, gjyqtaret per te cilet punoj me ofruan nje zgjatje te kontrates se praktikes deri ne fund-mars te 2024, pasi jane ndare shume te kenaqur me punen time. Problemi eshte qe fatkeqesisht financiarisht nuk e perballoj dot jetesen ketu pa burse, dhe sepse praktikat jane pa pagese. Duke qene se shume praktikante te tjere vijne me bursa nga qeverite e vendeve te tyre apo fondacione, mendova te perpiqem te komunikoj me ju per nje mundesi financimi per 3-4 muaj te tjere nese eshte e mundur.<br>Ndihem shume me fat qe jam perzgjedhur pasi Shqiperia nuk eshte e perfaqesuar mjaftueshem ne kete gjykate kaq prestigjoze. Jam shqiptarja e pare qe perzgjidhem per te punuar me gjykatesit, dhe sigurisht jam shume krenare qe vij si shqiptare ne kete institucion. Por, do ishte gjithashtu nder dhe vleresim per punen time nese qeveria shqiptare do mund te me ndihmonte sadopak ne vazhdimin e praktikes dhe mos t'a lija kete enderr pergjysem.<br>Nese e keni me te lehte, mund te ndaj me ju dhe numrin tim te telefonit, apo te ndaj cfaredolloj informacioni tjeter te nevojshem me ju, nga identifikimi i identitetit, certifikata, diploma, etj, deri te CV, leter motivimi, etj.<br>Shpresoj te jemi ne kontakt se shpejti. Ju falenderoj shume per kohen tuaj dhe shpresoj mos t'ju kem marre shume kohe nga axhenda juaj e dites. Ju uroj nje dite te mbare perpara. | 07.12.2023 | Përshëndetje,<br>Pasi shqyrtuam kërkesën tuaj, dërguar në adresën e Drejtorit të Përgjithshëm të AKFAL, ju bëjmë me dije se:<br>Bazuar në pikën 3, të nenit 112 të ligjit nr.80/2015, si dhe akteve nënligjore në fuqi që parashikojnë kushtet e përfitimit të mbështetjes studentore, ju sqarojmë se nuk mund të financoheni nga fondi i mbështetjes studentore, për periudhën 3-4 muaj të zgjatjes te kontratës së praktikës së punës pranë Gjykates Penale Nderkombetare ne Hage.<br>Ju faleminderit, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 63 | 05.12.2023 | Peshendetje mund te me dergoni nje konfirmim per aplikim per mbeshtetjen financiare per bursen e deges prioritare biokimi | 06.12.2023 | Pershendetje,<br>Ne pergjigje te kerkeses tuaj per informacion ju konfirmojme se aplikimi juaj eshte administruar nga AKFAL.<br>Ju falemiderit, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 64 | 05.12.2023 | Pershendetje jam Mariglen Zykaj nje student ne universitetin e vlores ne vitin e dyt ne degen e navigacionit , kam ne dore nj formular i cili esht per perfitim te mbeshtetjes financiare dhe bej pjes ne kriterin-C pasi jam nj programin studimi qe pe... | 06.12.2023 | Përshëndetje,<br>Referuar kerkeses tuaj, ju bëjmë me dije se ju mud të aplikoni në rrugë zyrtare, rrugë elektronike në adresën tonë të emailit, ose dorazi pranë ambienteve të AKFAL. Për të aplikuar, ju nevojitet vetëm formulari i aplikimit, të cilin duhet ta plotësoni me shkrim dore dhe ta firmosni.<br>Formularin mund ta gjeni bashkëngjitur sëbashku me shpalljen e aplikimit për mbështetjen financiare viti akademik 2023-2024. | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 65 | 07.12.2023 | mund Te vi nsr nga agjencia Kombetare te vij e ta Dorzoj Ju Faleminderit per mirkuptimin | 07.12.2023 | Përshëndetje,<br>AKFAL ushtron veprimtarinë e tij në adresën: Rruga "Naim Frashëri", nr. 37, Tiranë, ju mund të paraqiteni në zyart tona nga E hënë- E enjte ora 8:00-16:30 dhe të premten ora 8:00-14:00. Data 8.12.2023 është ditë pushimi zyrtar, ju mund të paraqiteni nga dita e hënë e në vijim. Gjithashtu, mund të na dërgoni dokumentacionin provues të çregjistrimit edhe në rrugë elektronike në email "info.akfal@arsimi.gov.al".<br>Ju faleminderit | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 66 | 07.12.2023 | Përshëndetje!<br>Jam Jonida Lisi , Studentja qe ka aplikuar per bursë financiare por që kam marr një përgjigje negative.Mund të di arsyjet se pse përgjigjja është negative.<br>Duke ju falenderuar për kohën tuaj,jam në pritje të një përgjigje!<br>Mirupafshim !Kalofshi mir!!! | 07.12.2023 | Përshëndetje,<br>Ju informojmë se nga verifikimi i kryer pranë QSHA (Qendra e Shërbimeve Arsimore), konfirmohet se:<br>“Programi për të cilin keni aplikuar për të përfituar mbështetje financiare është program i dytë studimi, pasi ju rezultoni se keni përfunduar/ndiqni studimet në një program tjetër studimi, konkretisht "Teknolog Laborant", Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan."<br>Ju falëminderit për mirëkuptimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 67 | 08.12.2023 | Jam nje student i vitit te pare ne matematike te Universitetit Luigj Gurakuqi Shkoder. Kisha nevoje te dija nese e keni marre aplikimin tim per burse. Disa nxensve te klases sime i ka ardhur konfirmimi. Une nuk kam marre asnje konfirmim dhe jam ne merak nese eshte gjithcka ne rregull me aplikimin qe kam bere apo te bej edhe nje here aplikim?<br>Duke ju uruar cdo te mire, jam ne pritje te pergjigjes suaj. Faleminderit! | 11.12.2023 | Pershendetje,<br>Ne pergjigje te kerkeses tuaj per informacion ju konfirmojme se aplikimi juaj eshte administruar nga AKFAL dhe eshte protokolluar me nr. 158/820, prot., date 22.11.2023.<br>Ju falemiderit, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 68 | 06.12.2023 | Bursa per dege prioritare a ka kriter note? | 07.12.2023 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të pyetjes tuaj ju informojmë se, procedura dhe kushtet e përfitimit të mbështetjes finaciare për studentët përfitues janë të parashikuara në VKM-në nr.386/2022, e ndryshuar të cilën e gjeni bashkëlidhur.<br>Ju falëminderit | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 69 | 07.12.2023 | Kam aplikuar por desha me dite a duhet te gjeje punen vete sipas rregullave? Tek bursa prioritare | 12.12.2023 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se në ikën 8, të VKM nr.386/2022, i ndryshuar, percaktohet se:<br>"Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas diplomimit deri në përmbushjen e detyrimit për punësim, përfituesit duhet të aplikojnë për çdo pozicion të lirë pune në institucionet e administratës buxhetore shtetërore dhe institucionet e pavarura publike. Në institucionet, në të cilat marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës, rekrutimi në pozicionet përkatëse i përfituesve kryhet me prioritet. Përfituesit, sipas këtij vendimi, punësohen nga Departamenti i Administratës Publike, në përputhje me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, për gjithë kohëzgjatjen e detyrimit për punësim.”<br>Ju falemiderit për mirekuptimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 70 | 11.12.2023 | Faleminderit per njoftimin e miratimit po ato leket kur do na i kaloni ?<br>Ne prill kur na i kaloni ju ne pothuajse e kemi perfunduar vitin akademik.<br>Me cfare supozohet ti mbulojme shpenzimet vjetore? | 19.12.2023 | Pershendetje,<br>Lista emerore me studentet te cilet do te vijojne mbeshtetjen financiare edhe per vitin akademik 2023-2024 ju eshte percjelle IAL-ve perkatese, per vijim procedure ne zbatim te marreveshjes trepaleshe.<br>Ju faleminderit, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 71 | 12.12.2023 | Jam një nxënëse në vitin e dyt Biologji ! Doja të dija nëse mund ta përfitoj bursën prioritare? Dhe nëse po çfarë duhet të bëj? | 12.12.2023 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të kerkeses tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se ju mud të aplikoni në rrugë postare ose dorazi pranë ambienteve të AKFAL në adresën Rruga "Naim Frashëri", nr.37, Tiranë, si dhe në rrugë elektronike në adresën tonë të emailit "info.akfal@arsimi.gov.al". Për të aplikuar, ju nevojitet vetëm formulari i aplikimit, të cilin duhet ta plotësoni me shkrim dore dhe ta firmosni. Formularin mund ta gjeni bashkëngjitur sëbashku me shpalljen e aplikimit për mbështetjen financiare viti akademik 2023-2024. Duke ju falënderuar për mirëkuptimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 72 | 12.12.2023 | Pershendetje ne baz te emailit qe me derguat qe un nuk e fitoja si burs doja te informoja pasi un nuk e kam ndjek arsimin e kaluar dhe jam e crregjistruar<br>Po ju dergoj me foto dhe crregjistrimin<br>Apo tju nis dhe njeher te gjitha dokumentat nga fillimi<br>Pasi kur kam pytur ne universitet me than qe une e mar si burs pasi nuk e kam ndjek si deg drejtsim dhe sjm paraqit thjesht jam crregjistru<br>Dhe jam ne vitin e par bacelor per Arsimin Parashkollor | 15.12.2023 | Përshëndetje,<br>Ju informojmë se AKFAL e ka administruar dokumentacionin tuaj të çregjistrimit.<br>Ju sqarojme se me qëllim që ju të rezultoni të regjistruar në program të parë studimi për vitin akademik 2023-2024, IAL-ja (Univeristeti, Akademia, Kolegji) në të cilën ju keni qënë të regjistruar më parë duhet të kryejë procedurat për çregjistrimit tuaj edhe pranë QSHA-së. Në këto kushte ju mund t'i drejtoheni IAL-së nga e cila jeni çregjistruar, që të vijojnë me procedurat e nevojshme.<br>Ju faleminderit, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 73 | 12.12.2023 | Pershendetje un jam e crregjistruar nga ai program studimi qe ndiqja dhe nuk po ndjek asnje program studimi te dyt per momentin pervec se deges prioritare arsim parashkollor! Faleminderit | 15.12.2023 | Përshëndetje,<br>Ju informojmë se AKFAL e ka administruar dokumentacionin tuaj të çregjistrimit. Ju sqarojmë se me qëllim që ju të rezultoni të regjistruar në program të parë studimi për vitin akademik 2023-2024, IAL-ja (Univeristeti, Akademia, Kolegji) në të cilën ju keni qënë të regjistruar më parë duhet të kryejë procedurat për çregjistrimit tuaj edhe pranë QSHA-së. Në këto kushte ju mund t'i drejtoheni IAL-së nga e cila jeni çregjistruar, që të vijojnë me procedurat e nevojshme.<br>Ju faleminderit, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 74 | 13.12.2023 | Pershendetje, jam studente dega Navigacion Universiteti Ismail Qemali Vlore doja te dija cfare dokumentacioni duhet te dorezoj per perfitim te burses si deg prioritare? | 13.12.2023 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të kerkeses tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se ju mud të aplikoni në rrugë postare ose dorazi pranë ambienteve të AKFAL në adresën Rruga "Naim Frashëri", nr.37, Tiranë, si dhe në rrugë elektronike në adresën tonë të emailit "info.akfal@arsimi.gov.al". Për të aplikuar, ju nevojitet vetëm formulari i aplikimit, të cilin duhet ta plotësoni me shkrim dore dhe ta firmosni. Formularin mund ta gjeni bashkëngjitur sëbashku me shpalljen e aplikimit për mbështetjen financiare viti akademik 2023-2024. Duke ju falënderuar për mirëkuptimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 75 | 13.12.2023 | Po llogaria bankare te kush banke duhet ju lutem ? | 14.12.2023 | Përshëndetje,<br>Ashtu sikurse jeni bërë me dije edhe në emailin e mëparshëm, për të aplikuar për mbështetje financiare ju nevojitet vetëm formulari i aplikimit, të cilin duhet ta plotësoni me shkrim dore dhe ta firmosni.<br>Duke ju falënderuar për mirëkuptimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 76 | 13.12.2023 | Pershendetje ne baz te emailit qe me derguat qe un nuk e fitoja si burs doja te informoja pasi un nuk e kam ndjek arsimin e kaluar dhe jam e crregjistruar<br>Po ju dergoj me foto dhe crregjistrimin<br>Apo tju nis dhe njeher te gjitha dokumentat nga fillimi<br>Pasi kur kam pytur ne universitet me than qe une e mar si burs pasi nuk e kam ndjek si deg drejtsim dhe sjm paraqit thjesht jam crregjistru<br>Dhe jam ne vitin e par bacelor per Arsimin Parashkollor<br>Pra une nuk kam nje diplom te bacelorit te kalum.<br>Faleminderit | 15.12.2023 | Përshëndetje,<br>Ju informojmë se AKFAL e ka administruar dokumentacionin tuaj të çregjistrimit. Ju sqarojmë se me qëllim që ju të rezultoni të regjistruar në program të parë studimi për vitin akademik 2023-2024, IAL-ja (Univeristeti, Akademia, Kolegji) në të cilën ju keni qënë të regjistruar më parë duhet të kryejë procedurat për çregjistrimit tuaj edhe pranë QSHA-së. Në këto kushte ju mund t'i drejtoheni IAL-së nga e cila jeni çregjistruar, që të vijojnë me procedurat e nevojshme.<br>Ju faleminderit, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 77 | 13.12.2023 | Pershendetje,<br>Vitin e kaluar jam regjistruar ne degen e informatikes per shkak se dega e fizikes nuk u hap. Kete vit kam bere ç’regjistrimin dhe kam kaluar ne degen e fizikes. Po j’u nis vertetimin e ç’regjistrimit nga dega e informatikes dhe nje vertetim qe jam student ne degen e fizikes.<br>Faleminderit! | 15.12.2023 | Përshëndetje,<br>Ju informojmë se AKFAL e ka administruar dokumentacionin tuaj të çregjistrimit. Ju sqarojmë se me qëllim që ju të rezultoni të regjistruar në program të parë studimi për vitin akademik 2023-2024, IAL-ja (Univeristeti, Akademia, Kolegji) në të cilën ju keni qënë të regjistruar më parë duhet të kryejë procedurat për çregjistrimit tuaj edhe pranë QSHA-së. Në këto kushte ju mund t'i drejtoheni IAL-së nga e cila jeni çregjistruar, që të vijojnë me procedurat e nevojshme.<br>Ju faleminderit, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 78 | 13.12.2023 | Pershendetje!<br>Se pari ka dy momente per tu futur ne nje fakultet. E para me dosjen e dokumentave dhe paraqitesh prane universitetit si dege e dyte. Pastaj eshte konkurimi nga fillimi si viti i pare nga A1Z dhe keta faktikisht jane si dege e pare sepse konkurojne me te drejta te barabarta. Urojme te shikoni mundesimin e financimit te deges qe kam aplikuar!<br>Ju Faleminderit! | 15.12.2023 | Përshëndetje,<br>Në vijim të komunikimeve, ju informojmë se pas verifikimit të kryer nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, konfirmohet se ju rezultoni me numër matrikullimi aktiv në sistem. Në pikën 3, të VKM 386/2022, i ndryshuar, përcaktohet kushti se mbështetjen financiare, e përfiton studenti për program të parë studimi. Pra studenti nuk duhet të ketë përfunduar/të je të duke ndjekur, një program tjetër studimi "Bachelor", "Profesional", apo të "Integruar".<br>Në mënyrë që ju të plotësoni kushtin e parashikuar, pra të rezultoni të regjistruar në program të parë studimi për vitin akademik 2023-2024, nevojitet që të kryehen procedurat e çregjistrimit tuaj pranë QSHA-së, nga IAL-ja (Univeristeti, Akademia, Kolegji) në të cilën ju keni qënë të regjistruar më parë, në një program studimi.<br>Ndërsa në rast se ju keni përfunduar një program studimi dhe programi për të cilin keni aplikuar për të përfituar mbështetje financiare është programi i dytë i studimeve, ju nuk plotësoni kushtin e sipërcituar.<br>Duke ju falënderuar për mirëkuptimin | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 79 | 13.12.2023 | une nuk ndjek studimet ne nje program te dyte | 15.12.2023 | Pershendetje,<br><br>Ne pergjigje te ankeses tuaj, lutemi nga ana juaj te na vendoset ne dispozicion:<br>a) vertetim çregjistrimi nese me pare keni ndjekur nje program studimi nga i cili jeni cregjitsruar;<br>b) ose vertetimi i regjistrimit ne programin e parë të stduimit per te cilin ju pretendoni s ekeni aplikuar. Ju faleminderit | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 80 | 14.12.2023 | Pershendetje,<br>Shkova u interesova perseri ne sekretarine e universitetit dhe sic provohet dhe shume qarte me dokumentin e c'regjistrimit qe ju dergova, rezultoj i cregjistruar nga dega e meparshme, si ne leter ashtu dhe ne sistem.<br>Tani, une pjesen time e kam bere, dhe po ashtu ka bere dhe universiteti. Qe do te thote, sipas kerkeses suaj, ju dergova dokumentin e c'regjistrimit, dhe universiteti gjithashtu ka kryer procesin e c'regjistrimit ne menyre te rregullt duke me dhene dhe mua dokumentin qe e verteton kete gje, te cilin, po e perseris, ja u kam derguar dhe juve me foto. Kaq kam ne dore une dhe kaq ka ne dore universiteti.<br>Keto qe po ju them nuk jane vetem fjalet e mia por dhe fjalet e personit pergjegjes qe eshte marre me ceshtjen time ne universitet.<br>Pjesen tjeter e keni ju ne dore, pra ti jepni drejtim kesaj situate, dhe te kryeni verifikimet e duhura ose te kontaktoni direkt me universitetin ku une kryej studimet per te verifikuar edhe njehere c'regjistrimin tim nga dega e meparshme, dhe studimet qe po ndjek ne degen perkatese qe eshte dhe dege me perparesi kombetare, dhe eshte e drejta ime sipas ligjit perkates qe te perfitoj ndihmen financiare.<br>Ndjehem shume i indinjuar me gjithe situaten qe eshte krijuar, duke ditur qe cdo gje qe une dhe universiteti ku une studioj kemi pasur ne dore e kemi kryer. Prandaj dhe do drejtohem ne ministri ne qofte se kesaj ceshtjeje nuk i jepet zgjidhje nga ana juaj, sepse nuk keni te drejte te me penalizoni per nje gabim qe nuk eshte as i imi dhe as i universitetit ku une studioj.<br>Ju falenderoj per kohen tuaj dhe shpresoj ta trajtoni ceshtjen time me me shume seriozitet dhe kujdes. | 19.12.2023 | Pershendetje,<br>AKFAL është duke kryer dhe nje here ri-verifikimin prane QSHA-se per studentët të cilët kane parashtruar se kanë përfunduar procesin e çregjistrimit ne QSHA.<br>Gjithsesi ju bejme me dije se AKFAL do te kerkoje nga IAL-te prane te cileve ju jeni duke ndjekur studimet aktualisht, per te realizuar edhe ata nje verifikim perfundimtar.<br>Faleminderit, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| | 14.12.2023 | Pershendetje, jam studente e vitit te pare ne programin mjekesi e pergjithshme, nga trojet, vkm (noten mesatare )kam 10.00 desha tju pyes per keto bursa a vlejne edhe per neve.<br>Faleminderit ! | 16.12.2023 | Pershendetje,<br>Sipas pikes 2 te VKM nr.386/2022, i ndryshuar mbeshtetjen fiannciare e perfitojne studentet shtetas shqipetar të pranuar në institucionet publike të arsimit të lartë.<br>Ju faleminderit, | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 81 | 14.12.2023 | Përshendetje ! Duke pasur parasysh përgjigjen tuaj e cila ishte që unë Adela Veseli si studente e vitit të parë në UBT dega Agroushqimore fakulteti i Bioteknologjisë dhe ushqimit nuk e perfitoj bursën sepse nuk qënka degë prioritare .Në fakt agroushqim... | 19.12.2023 | Pershendetje,<br>Ne pergjigje te emailit tuaj ju bejme me dije se ju keni aplikuar per të përfituar mbështetje financiare në programin e studimit "Inxhinieri Agroushqimore, Profili: Teknologji Ushqimore". Emërtimi i programit për të cilin ju keni aplikuar, ka shmangie te madhe nga emërtimi i programit të studimit parashikuar në listën e shtojcës nr.1 bashkëngjitur VKM nr.386/2022. Legjislatori ka përdorur në emërtimet e programeve të tjera termin "Inxhinieri", ndërsa në këtë rast ai ka përcaktuar si program prioritar "Agroushqimin", pasi nuk ka qënë qëllimi për ta cilësuar si program prioritar programin "Inxhinieri Agroushqimore".<br>Ju falemiderit, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 82 | 18.12.2023 | Pershendetje !<br>Pra une figuroj ne degen agroushqim si program i pare studimi dhe eshte kryer çrregjistrimi mga dega histori -gjeografi . Pra jam ne rregull ?<br>Nqs mundeni me ktheni pergjigje .<br>Faleminderit ! | 19.12.2023 | Pershendetje,<br>AKFAL është duke kryer dhe nje here ri-verifikimin prane QSHA-se per studentët të cilët kane parashtruar se kanë përfunduar procesin e çregjistrimit ne QSHA.<br>Gjithsesi ju bejme me dije se AKFAL do te kerkoje nga IAL-te prane te cileve ju jeni duke ndjekur studimet aktualisht, per te realizuar edhe ata nje verifikim perfundimtar.<br>Faleminderit, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 83 | 15.12.2023 | Pershendetje. Jam student ne deget prioritare ne vite te pare ne Universitetin Bujqesor. Tirane. Un e kam universitet te dyte. Ju lutem perfitoj nga bonusi qe jepet per keto dege. Falem | 16.12.2023 | Përshëndetje,<br>Ne pergjigje te kerkeses tuaj jua informojme si me poshte:Në pikën 3, të VKM 386/2022, i ndryshuar, përcaktohet kushti se mbështetjen financiare, e përfiton studenti për program të parë studimi, vetëm për njërën nga kategoritë e përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi.<br>Sa me siper, ju nuk mund te perfitoni mbeshtetje fannciare per nje program te dyte studimi.<br>Duke ju falënderuar për mirëkuptimin | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 84 | 15.12.2023 | Pershendetje,<br>Faleminderit per asistencen e deritanishme. Sipas udhezimit tuaj, QSHA e ka marre zyrtarisht vertetimin e crregjistrimit nga fakulteti i dhe shpresoj ta procesojne ne kohe. Une ju kam kerkuar tju kontaktojne zyrtarisht dhe te konfirmojne crregjistrimin dhe fshirjen e numrit te vjeter te matrikullimit nga regjistri, ne menyre qe sipas udhezimit tuaj une te klasifikohem per mbeshtetje financiare. Duke qene se data e fundit eshte data 18 dhe une nuk jam i sigurt nese ata do ta zhvillojne ne kohe proceduren, do tju lutesha qe dhe nje here te fundit ti kontaktonit ne lidhje me rastin tim. Me vjen keq qe me duhet te insistoj kaq shume ne lidhje me kete teme, mirepo shpresoj ta kuptoni sa me rendesi eshte kjo mbeshtetje financiare per mua.<br>Shpresoj ne nje pergjigje pozitive ose nje udhezim te ri mbi hapa te tjere qe me duhet te ndjek, pasi mungesa e informacionit eshte e madhe dhe ju jeni te vetmit qe me keni dhene informacion te vlefshem dhe hapa te qarte mbi ate qe duhet te bej.<br>Ju uroj pune te mbare. | 19.12.2023 | Pershendetje,<br>AKFAL është duke kryer dhe nje here ri-verifikimin prane QSHA-se per studentët të cilët kane parashtruar se kanë përfunduar procesin e çregjistrimit ne QSHA.<br>Gjithsesi ju bejme me dije se AKFAL do te kerkoje nga IAL-te prane te cileve ju jeni duke ndjekur studimet aktualisht, per te realizuar edhe ata nje verifikim perfundimtar.<br>Faleminderit, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 85 | 18.12.2023 | Pershendetje! Kisha nje paqartesi ne lidhje me mbeshtetjen financiare qe perfitojne studentet e degeve prioritare. A e kam te drejten ta refuzoj kete (ne rast se e perfitoj) edhe pse e kam dorezuar kerkesen? Jam duke lexuar ligjin me hollesi dhe e kam te paqart si funksionon pjesa e diplomes. | 29.12.2023 | Pershendetje,<br>Sipas VKM nr.386/2022, i ndryshuar ju perfitoni mbeshtetjen financiare dhe merrni persiper detyrimet e parashikuara ne kete vendim, vetem ne rast se pranoni te nenshkruani marreveshjen tre-paleshe.<br>Ju faleminderit | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 86 | 21.12.2023 | Pershendetje!<br>Uroj qe ky email t'ju gjej sa me mire.<br>Ju lutem kerkoj informacion mbi aplikimin e bere ,ne perfitim te burses per lendet prioritare.<br>Faleminderit dhe pune te mbare. | 31.12.2023 | Peshendetje,<br>Ne vijim te kekrkeses tuaj per informacion ju bejme me dije se, aplikimet e studenteve sipas kriterit te pikes 2/c te VKM nr.386/2022, i ndryshuar jane derguar prane IAL-ve perkatese per vijim procedure per perzgjedhjen e studenteve sipas parashikimeve ne aktet nenligjore ne fuqi.<br>Ju faleminderit, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |